

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

PROGRAMI

I. Titulli i Programit: *Kualifikim profesional bazë për broker në sigurime*

II. Kategoria e Programit:

kualifikim profesional bazë kualifikim profesional në vazhdimësi

III. Objektivat e Programit:

- Njohja e kuadrit ligjor mbi aktivitetet e sigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime, terminologjia e produkteve të sigurimit dhe ndikimet e ligjeve të veçanta në veprimtarinë e sigurimit.
- Konceptet themelore, llojet e sigurimit sipas klasave dhe llojeve të sigurimit (sigurimit të jetës dhe jo-jetës), kontratat e risigurimit, rreziku në sigurime, etj.
- Asimilimi i parimeve themelore të etikës profesionale në shpërndarjen e produkteve të sigurimit dhe teknikave të veçanta të shitjes për produktet e sigurimit.

IV. Grupet e synuara:

- Individët që duan të ndjekin një karrierë profesionale ndërmjetësimi si broker në sigurime;
- Personat që punojnë si broker në sigurime, pa trajnim të specializuar të kërkuar më parë.

V. Kushtet:

- Arsim i lartë i vërtetuar me diplomë universitare.

VI. Përmbajtja e Programit:

Modul 1 – Parimet e përgjithshme në sigurime

- Mënyra si përdoret parimi i dëmshpërblimit për të zgjidhur pretendimet në sigurime dhe marrëdhëniet me parimet e tjera që mbështesin këtë parim;
- Kërkesat për Interes të Sigurueshëm në një kontratë sigurimi;
- Domosdoshmëria e mirëbesimit të plotë që i jepet propozuesit, të siguruarit dhe siguruesit;
- Pasojat e një shkeljeje së mirëbesimit të plotë;
- Si aplikohet shkaku kryesor për të përcaktuar shkaku dhe rrjedhimisht statusin e një pretendimi në sigurime;
- Raste ushtrimore.

Modul 2 – Roli i AMF në ndërmjetësimin në sigurime

- Licencimi i ndërmjetësve në sigurime;

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

- Monitorimi i veprimtarisë së tyre;
- Mbrojtja e konsumatorit;
- Mbiqëqyrja e ndërmjetësve në sigurime dhe kompanive të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime;
- Mbiqëqyrja e shoqërisë së sigurimit;
- Raste konkrete.

Modul 3 Karakteristikat e kontratës së sigurimit

- Kushtet e përgjithshme dhe kushtet e vecanta;
- Deklarimet, përkufizimet, ngjarja e siguruar, përjashtimet, të zbritshmet, bashkësigurimi etj.

Bazat e legjislacionit specifik për veprimtarinë e sigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe terminologjinë specifike të produkteve të sigurimit

- Legjislacioni mbi aktivitetin e sigurimit dhe të ndërmjetësimit në sigurime dhe terminologjia specifike e produkteve të sigurimit;
- Statusi ligjor i ndërmjetësve dhe lloje të tjera të shpërndarësve në sigurime dhe risigurime;
- Kontrata e ndërmjetësimit në sigurime. Efektet e ndërmjetësimit. Marrëdhënia juridike: sigurues - ndërmjetës - i siguruar;
- Kontrata e sigurimit. Rregullat në lidhje me përfundimin e kontratave të sigurimit nga ana e ndërmjetësve në sigurime;
- Klasat e Sigurimeve dhe grupimi i tyre;
- Procedura e ndërmjetësimit deri tek pagesa e dëmit.

Modul 4 Edukim në lidhje me teknikën aktuariale në sigurime

- Elementët përbërës të primit të sigurimit;
- Qasja teorike dhe empirike në përcaktimin e primit të riskut;
 - Qasja empirike: kosto mesatare, frekuenca e dëmeve, etj;
 - Qasja teorike: vlera e pritshme e dëmshpërblimeve totale. Modelimi i numrit të dëmeve, modelimi i pagesave të dëmeve;
- Ngarkesat mbi primin e riskut;
- Modeli *Bonus-Malus*: arsyet e përdorimit, rregullat e tranzicionit të sistemit *Bonus-Malus*, përcaktimi i primit të tarifës;
- Treguesit kryesore të paralajmërimit të hershëm;
- Performanca financiare e shoqërisë së sigurimit;
- Provigjonet teknike dhe asetet e shoqërisë së sigurimit;
- Likuidimi i dëmeve.

Modul 5 Kanalet e shpërndarjes dhe fokusi tek ndërmjetësit

- Marketingu dhe shitjet në sigurime

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

- Shitjet dhe shërbimi ndaj klientit;
- Marketing dhe zhvillim produkti;
- Administrimi i policave;
- Sistemet e aktivitetit të shitjes;
- Përgatitja për të shitur: menaxhimi i kohës, përcaktimi i qëllimit, kërkimet, normat e konvertimit;
- Qasja e konsumatorit: qëllimi, llojet, kundërshtimet, teknikat e zgjidhjes së kundërshtimeve, llojet e konsumatorëve;
- Formulimi dhe paraqitja e zgjidhjeve.
- Mashtrimi në sigurime
- Raste konkrete

Modul 6 Prezantimi i llojeve të kontratave të sigurimit dhe të risigurimit të Jo-Jetës

- Llojet dhe prezantimi i produkteve të përgjithshme sigurimit (specifika të sigurimit të përgjithshëm, llojet e sigurimit);
- Sigurim shëndetësor dhe i aksidenteve (sigurimi i aksidenteve të personave, sigurimi shëndetësor, sigurimi për shpenzimet mjekësore jashtë vendit);
- Sigurimet motorrike (KASKO, përgjegjësitë motorrike - MTPL, Kartoni Jeshil), sigurimi i përgjegjësive për mallrat e transportuara, sigurimi i mallrave gjatë transportit rrugor;
- Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë (sigurimi i shtëpisë dhe sigurimi i familjes; sigurimi i pronës industriale dhe tregtare, sigurimi i pajisjeve elektronike dhe dëmtimet aksidentale, sigurimi në ndërtim dhe montimi);
- Përgjegjësia në sigurim (detyrimi ligjor dhe kontraktual);
- Elemente të kontratës;
- Cilat elementë e bejnë një kontratë të mirëfilltë.

Modul 7 Risigurimi

- Hyrje: Sigurimi për shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit;
- Risigurimi, Retrocedimi, Fronting, Captives, etj;
- Arsyet e përdorimit të risigurimit:
 - limitimi i ekspozimit (diversifikimi i rrezikut), shmangia e humbjeve të mëdha, zbutja e rezultateve financiare, përmirësimi i aftësisë paguese, rritja e kapacitetit në pranimin e rreziqeve, asistenca financiare/ekspertiza;
- Mënyrat e përdorimit/shkrimit të risigurimit;
- Risigurimi fakultativ: avantazhet, disavantazhet;
- Risigurimi “treaty”: avantazhet, disavantazhet;
- Tipet e risigurimit:
 - Risigurimi proporcional: marrëveshje me ndarje të kuotave, marrëveshjet shumëfish;
 - Risigurimi jo-proporcional: marrëveshjet në tejkallim të humbjes (risk XL, agregate XL, katastrofë XL);

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

- Risigurimi financiar;
- Mënyrat e operimit të marrëveshjeve;
- Faktorët që ndikojnë në nevojat për risigurim;
- Përcaktimi i risigurimit më të përshtatshëm.

Modul 8 Përfshirja e ligjeve të veçanta në aktivitetet e sigurimit

- Detyrimet në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit;
- Detyrimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale;
- Detyrimet në lidhje me parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Aktiviteti i brokerimit si ndërmjetës në sigurime

- Shitësi profesional; rregullat për të pasur sukses në shitjen e produkteve të sigurimit;
- Trajtimi i Dëmeve dhe shërbimi ndaj klientit;
- Burimet njerëzore dhe zhvillimi profesional;
- Shitësi profesional; rregullat për të pasur sukses në shitjen e produkteve të sigurimit;
- Analiza e nevojave të konsumatorit;
- Negocimi dhe përfundimi i kontratës;
- Shërbimet e ofruara gjatë kontratës së sigurimit;
- Kuptimi i parimeve themelore të **etikës** në biznes.

Modul 9 Prezantimi i klasave dhe llojet e kontratave të sigurimit të Jetës

- Çfarë është sigurimi i Jetës;
- Llojet e sigurimit të Jetës;
- Fusha e mbulimit;
- Rëndësia;
- Roli i sigurimeve të jetës në zhvillimin ekonomik;
- Pamje e përgjithshme e sigurimit të Jetës;
- Llojet e policave të sigurimit të Jetës: policat e sigurimit të Jetës me afat, policat me kursim;
- Kushtet për kryerjen e sigurimeve/karakteristikat e nevojshme për rrezikun e sigurueshëm;
- Sigurimi i Jetës me kursim (*endowment*);
- Procedura e marrjes në sigurim;
- Krahasim i produkteve dhe elementet e kostove;
- Njohja e profilit të klientit;
- Rreziku që mund të mbajë klienti;
- Disa elementë të administrimit të rrezikut – kompani ose individë;
- Cila është kosto që i ofrohet më mirë klientit;
- Krahasimi i produkteve;
- Pse është e përshtatshme për klientin.

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Modul 10 Produktet kryesore në sigurimin e Jetës;

- Primet dhe përfitimet e paguara;
- Rreziqet kryesore;
- Nevojat e të siguruarve;
- Kanalet e shpërndarjes;
- Broker, agjentë, punonjësit e shitjes, marketingu direkt.
- Efektet e kanaleve të ndryshëm të shpërndarjes mbi portofolin e përgjithshëm;
- Mjedisi rregullator;
- Dizenjimi i produktit: faktorët që konsiderohen;
- Përcaktimi i primit të sigurimit: tabelat e mortalitetit, probabiliteti i mbijeteses, norma e mortalitetit, faktori i aktualizimit.

Prezantimi i klasave dhe llojet e kontratave të sigurimit të Jetës

- Kontratat e sigurimit të lidhura me fondet e investimit;
- Krijimi i shportave të investimit për kontratat e lidhura me fondet e investimit;
- Menaxhimi i riskut në shoqërinë e sigurimit të jetës, ndikimi në aftësinë paguese të saj.

VII. Kohëzgjatja e Programit: 50 orë (10 ditë x 5 orë/ditë) në orarin 11:30 – 16:30.